Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Fatmir Krasniqi	**14.11.2023**	**26.11.2023**	**2023/0900**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 13,11.2023, OE **" Pro-Medical**" SH.P.K., adresa Kadri Zeka Ferizaj, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0900, kunder njoftimit mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me pajisje mjeksore, lot III**me nr. te prokurimit: **615-23-1754-1-1-1**iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Podujevë. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlerë e madhe, vlera e parashikuar e kontratës: **160,000,00€**. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotesuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1- Qëllimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës.

Neni 11 – Informatat Sekrete

Neni 54- Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

9 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve

Kjo Ankese dorëzohet ne përputhje me Nenin 109 te Ligjit për Prokurimin Publik ne Autoriteti Kontraktues, bazuar në kërkesën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për

Kontrate, ka klasifikuar te gjitha informacionet e Ofertës se operatorit tjetër, si informacione sekrete

afariste. Dokumentet e vetme tek te cilat është dhëne qasja, përfshijnë janë dokumente bazike dhe jo relevante për ne qe te paraqesim Ankesën konform LPP.

Pretendimi Ankimor 1: Objekti i ofertës dhe kontratës me Autoritetin Kontraktues nuk

mund te klasifikohet si sekret afarist

OE Ankues Pro Medical ka kërkuar qasje në dokumentet tenderuese të OE te rekomanduar për Kontrate për LOT III ne lidhje me Aktivitetin e prokurimit në fjale.

Në bazë të përgjigjes nga përfaqësuesi i AK, nuk është lejuar qasje ne informacionin se me çfarë pajisje ka ofertuar, dhe cili është objekt i ofertës dhe kontratës me AutoritetinKontraktues. Një gjë e tille ndalohet ne mënyre shprehimor. Te lejohet një klasifikim i objektit Neni 42 sepse asnjë sqarime nuk kemi pranuar nga AK pse jemi eliminuar vetëm një Arsyetim gjeneral per katalog. Republikën e Kosovës.

Kjo eshte Ankesa e dyte per kete aktivitet te prokurimit ju luteem shiko Vendimin e OSHP 422-23

5 / **7** te ofertës te klasifikohet ndalohet specifikisht edhe me Rregullat e Prokurimit Publike dhe me Vendimet e e marr nga OSHP për rastet konkrete.

Ju lutem shikoni email si deshmi se AK nuk ka zbatur Vendimin e OSHP Nr.422-23 dhe LPP Neni 10 paragrafi 5.

Pra AK nuk ka thene qasje konform paragrafit 5 por ka thene vetem ti shikojm dokumentet ne menyre vizuele ne zyren e prokurimit, qe kjo pamundeson nje vlersim dhe krahasimi te behet i plote sepse nuk behet egazamini,vlersimi dhe krahasimi nga ne ne menyre vizuele pa pasur kopje dokumente dokumente siq e parashe Neni 10.5 pra kopje qe te na mundesoj nje vlersim nga stafi jone dhe qe te beje pa presioni nga AK, sepse ne zyren e prokurimit ne nuk mund te bejem vlersim.

Oferta se me çfarë pajisje ka ofertuar një kompani, dhe me cilin prodhues, nuk lejohet te klasifikohet si sekret afarist, ngase nuk përfshihet as ne Nenin 68 dhe as Nenin 69 te LPPsë. Pasi që ne fizikisht kemi shkuar në Zyren e Prokurimi, me date 31.10.2023 nga ZPP verbalisht dhe pastaj edhe me shkrim email se ju refuzohet kopje ne dokumentet e Grupin e OE "NERAMED & KO MED" me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar Për shkak se ka dyshime te bazuara se OE i rekomanduar për Kontrate nuk i plotëson kërkesat e Dosjes se Tenderit, si dhe specifikacionet teknike për LOT III dhe domentetet tjera relevante të Dosjen e Tenderit, OE Ankues ka kërkuar qasje ne dokumentet tenderuese ne fjale.

Pretendimi Ankimor 2: Pra vlersimi nuk eshte bere konform LPP dhe arsytimet e cekura ne LS nuk jane konform LPP .

Neni 54- Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar- AK nuk ka respektuar as Neni 54 te LPP lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe në kundërshtime me RrPP Neni 42 sepse asnjë sqarime nuk kemi pranuar nga AK pse jemi eliminuar vetëm një Arsyetim gjeneral si me poshtë.

Kurse Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)Neni 54 citim " 1.*Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt" Njoftimi i tillë duhet që së paku të përmbaje informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse në përputhshmëri me: 1.1. në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati.* 6 / 7 *1.2. në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të*

parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit të ri- vlerësimit është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe me datë 27.10.2023 është ngritë në platformën elektronike E-prokurimi. Ku është rekoamnduar për kontratë grupi i OE Neramed& KO-MED si OE i përgjegjshëm me çmimin me të ulët për lot III

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

OSHP: 2023/0422

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE PRO MEDICAL SH.P.K. me nr. 2023/0422, e datës 22/06/2023, kurse vendimi i AK KOMUNA E PODUJEVËS lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore" me numër të prokurimit 615-23-1754-1-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit (Lot 3) kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PRO MEDICAL SH.P.K.**

Sqarim Hyrës

OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht përmes vendimit nr. 422/23 të lëshuar me datë 15.09.2023 ishin trajtuar dhe janë konsideruar si të bazuara. Sipas vendimit të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku ishte rekomanduar për kontratë grupi i OE Neramed & Ko-MED për lot III. Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë të njëjta me atë të paraqituara në ekspertizën me nr. 422/23 dhe në vendimin e Panelit Shqyrtues me nr. 422/23 të lëshuar me datë 15.09.2023. Përkundër që vendimi ka rezultuar me ri-vlerësim nënkupton se pretendimet ankimore kanë qenë të bazuara dhe AK ka pas për obligim që të evitoj shkeljet e konstatuara në raport të ekspertizës dhe në vendim të OPSH-së dhe ti korrigjoj ato përmes ri-vlerësimit. Por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin ri-vlerësimit edhe pse në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 16 Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar edhe më parë nga ana e Panelit Shqyrtues dhe konsideroj se çështja të trajtohet si " Res- Judicata".

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PRO MEDICAL SH.P.K.**

Fatmir Krasniqi